L I G J
Nr.9567, datë 19.6.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8701, DATË 1.12.2000 "PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "Ministri i Financave" zëvendësohen me fjalët "ministri përgjegjës për ekonominë"; fjalët "Ministria e Financave" zëvendësohen me fjalët "ministria përgjegjëse për ekonominë"; fjalët "Ministria e Rendit Publik" zëvendësohen me fjalët "ministria përgjegjëse për rendin publik".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe hipodromet krijohet Komiteti i Lojërave të Fatit, si një strukturë ad hoc, pranë ministrit përgjegjës për ekonominë. Përbërja, përgjegjësitë dhe mënyra e organizimit të këtij Komiteti përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 4

Pika 2 e nenit 11 ndryshohet si më poshtë:
"2. Organizatori i lojës së fatit duhet të bëjë kërkesë me shkrim në ministrinë përgjegjëse për ekonominë për rinovimin e lejes, të paktën 6 muaj përpara mbarimit të afatit të lejes së dhënë.".

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

Ministri përgjegjës për ekonominë bashkëpunon me ministrin përgjegjës për rendin publik për dhënien e lejeve për ushtrim veprimtarie për kazinotë dhe hipodromet.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 13 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli i Ministrave përcakton zonat ku mund të hapen kazinotë, ministri përgjegjës për ekonominë dhe ministri përgjegjës për rendin publik, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, përcaktojnë numrin e kazinove, që mund të hapen në çdo zonë të përcaktuar sipas këtij neni. Organizatori i pajisur me leje nuk mund të hapë më shumë se një kazino në zonat e përcaktuara sipas këtij neni.”.

Neni 7

Pas nenit 30 shtohen nenet 30/1 dhe 30/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

1. Organet tatimore bëjnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së personave juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit në fuqi “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ministri përgjegjës për ekonominë dhe Ministri i Financave përcaktojnë, me udhëzim të përbashkët, procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të bashkëpunimit ndërmjet organeve të varësisë për realizimin e kontrollit. Organi tatimor i dërgon ministrit përgjegjës për ekonominë informacion tremujor për shlyerjen e detyrimeve nga subjektet e licencuara, për të ushtruar veprimtari në lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë i kërkon organit tatimor ose organeve të tjera shtetërore të bëjnë mbylljen e veprimtarisë për subjektet, të cilat nuk janë të licencuara për organizimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe hipodromet në të gjitha rastet kur këto konstatohen nga kontrollet e ushtruara nga kjo ministri.

Neni 30/2

Transferimi, shitja, lënia peng dhe çdo formë tjetër e disponimit të aksioneve të shoqërive të licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe hipodromet bëhen me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për ekonominë.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4963, datë 5.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu